

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në Expocity Albania

Universiteti i Elbasanit pjesëmarrës në Festivalin Skills Careers and Jobs, organizuar nga AlbanianSkills me mbështetjen e Expocity Albania.

Universiteti i Elbasanit u përfaqësua nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, të cilët diskutuan dhe ndanë eksperiencën e tyre në fushën e këshillimit të karrierës, aktivitetet që zhvillohen me studentët, lidhjet e forta që ruajmë me alumnin tonë, por sigurisht duke cilësuar edhe sfidat që na presin në të ardhmen.

Në përfundim të Panelit tematik 4 : Edukim dhe udhëzim për karrierë; Zhvillimet dhe sfidat, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, ftoi studentët dhe nxënësit që ishin pjesëmarrës në këtë aktivitet, që të vizitojnë Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe të për zgjedhin nga larmishmëria e programeve të studimit, shërbimeve, mundësive dhe aktiviteteve që ofrojmë.



